



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të neneve 11, 14.2 të Ligjit për Vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, nenit 7 paragrafi 3 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 4 të Rregullores QRK 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, dhe nenet 14 dhe 17.1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2017, miratoi,

VENDIM

PËR MIRATIM PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS, PËR VENDOSJEN E PANOVE REKLAMUESE – BILLBOARD NË DISA RRUGË TË QYTETIT TË PODUJEVËS

Neni 1

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të paluajtshmërive në pronësi të Komunës, për vendosjen e panove reklamuese – billboard në disa rrugë të qytetit të Podujevës, si vijon:

1. Rruga "Skënderbeu":

- Në afërsi të SHFMU "Ibrahim Rugova" - copë 1 (një)
- Në afërsi të SHFMU "Enver Maloku" - copë 1 (një)
- Në afërsi të SHMLT "Fan S. Noli" - copë 1 (një)
- Në afërsi të varrezave të qytetit (te Eurobllok) - copë 2 (dy)
- Në afërsi të udhëkryqit në rrugën "Lugina e Preshevës" - copë 1 (një)

2. Rruga "Zahir Pajaziti":

- Në afërsi të objektit të Postës së qytetit - copë 2 (dy)
- Në afërsi të SHML Ekonomike "Isa Boletini" - copë 1 (një)
- Në afërsi të lokalit afarist (kafiteria "Boem") - copë 1 (një)

3. Në afërsi të udhëkryqit që lidh rrugët "Zahir Pajaziti" dhe "Xhemajl Mustafa", - copë 1 (një)

Dimensionet e panove reklamuese – Billboard do të jenë 400 cm X 300 cm

Neni 2

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të paluajtshmërive, është vendosja e panove reklamuese – billboard.

Neni 3

Pjesët e hapësirave publike jepen në shfrytëzim afatshkurtër për periudhën 5 vjeçare.

Neni 4

Procedura e dhëniens në shfrytëzim afatëshkurtër realizohet përmesë konkurrences së hapur publike përkatësisht ankandit publik, konform Rregullores (QRK) 23/2013 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palutjshme të Komunës.

Neni 5

Komisioni i ngritur nga Kuvendi, pas zbatimit të procedurave të konkurrencës së hapur publike, Kryetarit të Komunës i dërgon ofertën e përzgjedhur për lidhjen e kontratës me të cilën rregullohen të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit.

Neni 6

Zbatimin e Vendimit e bën Komisioni vlerësues për dhënie e pronës së palutjshme të Komunës dhe Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

Neni 7

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-060/04-26132/17

Podujevë,

31 mars 2017

Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi

